



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË URDHRI I INFERMIERIT TË SHQIPËRISË

Urdhri i Infermierit përbëhet nga infermierët dhe mamitë, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e që kanë diplomën përkatëse dhe që e ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë.

Shtetasit shqiptarë dhe të huaj, të diplomuar si infermierë ose mami fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e në Republikën e Shqipërisë, bëhen menjëherë anëtarë të Urdhrit, me pagimin e kuotizacionit dhe regjistrimin pranë tij.

Personi, që kërkon të ushtrojë një profesion të rregulluar, duhet të ketë përfunduar programin përkatës të akredituar të studimit dhe/ose kualifikime profesionale në atë profesion, të cilat vërtetohen me dokumente zyrtare, të lëshuara brenda ose jashtë vendit dhe të njohura në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Për të fituar të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, çdo kandidat duhet:

- a) të kryejë praktikën profesionale;
- b) të kryejë provimin e shtetit;
- c) të regjistrohet në UP-në përkatëse.

### **Dokumentet per pajisje me licensë**

1. Kërkesë për anëtarësim.
2. Fotokopje të noterizuar të diplomës (dëshmisë ose dëftesës së shkollimit shoqëruar me listë notash).
3. Fotokopje të një dokumenti identifikimi (kartë identiteti, pasaporte).
4. Katër fotografi (prerje normale).
5. Një CV.
6. Vërtetim nga qendra e punës (nëse është në marrëdhënie pune).
7. Fotokopje të librezës së punës (nëse e disponon atë).

8. Çertifikatat e marra nga kualifikime të ndryshme (fotokopje).
9. Fotokopje e liçensës nga Ministria e Shëndetësisë (nëse ka marrë).

**Dokumentet për rinovimin e liçensës**

1. Leja e ushtrim profesionit
2. Dy fotografi
3. Vertetim pune
4. Vertetim kreditesh

***Tarifat e dokumentave që lëshohen nga Urdhri i Infermierit të Shqipërisë***  
***Lloji i dokumentit/Tarifa :***

<b>1. Karta e identitetit profesional</b>	<b>200 Lek</b>
<b>2. Depozitim dosje për anëtarët e rinj</b>	<b>1 500 Lek</b>
<b>3. Leja e të drejtës së ushtrimit të profesionit</b>	<b>5 000 Lek</b>
<b>4. Kuotizacioni 5-vjecare për profesionistet si Infermier, Mami, Infermieri-Mami, Fizioterapi, Teknik-Imazherie, Teknik-Laboratori, Logopedi</b>	<b>6 000 Lek</b>
<b>5. Tarifa e ricertifikimit (1 herë në 5 vjet)</b>	<b>5 000 Lek</b>
<b>6. Dublikatë i lejes së ushtrimit të profesionit</b>	<b>1 000 Lek</b>
<b>7. Tarifa për kryerjen e praktikës profesionale</b>	<b>3 000 Lek</b>